FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 40	**2002**	**Korrik**

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr. 8921 datë 11.7.2002 — Për ratifikimin e "Konventës nr. 174 "Parandalimi i aksidenteve të rënda në industri, 1993"" të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ……. 1183

L I G J
Nr.8921, datë 11.7.2002

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NR. 174 "PARANDALIMI I AKSIDENTEVE TË RËNDA NË INDUSTRI, 1993"" TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa nr. 174 "Parandalimi i aksidenteve të rënda në industri, 1993"" e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3412, datë 22.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

C 174: KONVENTA PËR PARANDALIMIN E AKSIDENTEVE
TË RËNDA NË INDUSTRI

Konventa në lidhje me Parandalimin e Aksidenteve të Rënda në Industri
(Shënime: data e hyrjes në fuqi: 3.1.1997)
Konventa: C 174
Vendi: Gjenevë
Sesioni i Konferencës: 80
Data e miratimit: 22.6.1993
Shih ratifikimet për këtë Konventë
Dokumenti është paraqitur në: frëngjisht, spanjisht
Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E thirrur në Gjenevë nga Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në sesionin e saj të 80-të, më 2 qershor 1993,

Duke parë konventat dhe rekomandimet përkatëse ndërkombëtare të punës, veçanërisht, Konventën dhe Rekomandimet për Shëndetin dhe Sigurimin në Punë, 1981, Konventën e Rekomandimet për Kimikatet, 1990, duke theksuar nevojën e një qëndrimi global të përbashkët, dhe

Duke u nisur nga Kodi i ILO mbi praktikat për parandalimin e aksidenteve të rënda në industri, botuar më 1991, dhe

Duke pasur parasysh nevojën për të siguruar marrjen e masave të nevojshme për:

a) parandalimin e aksidenteve të rënda;

b) minimizimin e rrezikut të këtyre aksidenteve;

c) minimizimin e efektit të këtyre aksidenteve, dhe

Duke pasur parasysh shkaqet e këtyre aksidenteve, përfshi gabimet organizative, faktorin njeri, mosplotësimin e komponentëve, devijimin nga kushtet normale të funksionimit, jashtë influencave dhe forcave të natyrës, dhe

Duke u nisur nga nevoja për kooperim, në kuadrin e Programit Ndërkombëtar mbi Sigurimin nga Kimikatet, ndërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Programit të Kombeve të Bashkuara për Ambientin dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si edhe me organizata të tjera ndërqeveritare

përkatëse, dhe

Pasi kanë vendosur për miratimin e propozimeve të ndryshme në lidhje me parandalimin e aksidenteve të rënda në industri, e cila është pika e katërt në axhendën e sesionit, dhe

Pasi kanë vendosur që këto propozime të marrin formën e një konvente ndërkombëtare;

Miratojnë sot, më njëzet e dy qershor, të vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre, konventën e mëposhtme, e cila do të quhet Konventa për Parandalimin e Aksidenteve të Rënda në Industri, 1993.

PJESA I:
FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRCAKTIMET

Neni 1

1. Qëllimi i kësaj Konvente është të parandalojë aksidentet e rënda nga lëndët e rrezikshme dhe të minimizojë pasojat e aksidenteve të tilla.

2. Kjo Konventë aplikohet për instalimet e mëdha të rrezikshme.

3. Kjo Konventë nuk zbatohet për:

a) instalimet e mëdha bërthamore dhe uzinat që përpunojnë lëndë radioaktive, me përjashtim të rasteve kur në këto instalime përdoren lëndë joradioaktive;

b) instalimet ushtarake;

c) transportimi jashtë ambienteve të këtyre instalimeve, me përjashtim të tubacioneve.

4. Anëtari që ratifikon këtë Konventë, pas konsultimit me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve e punëmarrësve të interesuar dhe palë të tjera të interesuara, mund të përjashtojë nga aplikimi i kësaj Konvente instalime apo degë të aktiviteteve ekonomike për të cilat është siguruar një mbrojtje e njëjtë.

Neni 2

Kur dalin probleme të veçanta e të rëndësishme dhe kur nuk është e mundur të implementohen menjëherë të gjitha masat parandaluese e mbrojtëse që shprehen në këtë Konventë, çdo Anëtar duhet të hartojë, në konsultim me organziatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe me palë të tjera të interesuara që preken nga kjo, plane për implementimin me sukses të masave të mësipërme dhe me afate të fiksuara.

Neni 3

Për qëllim të kësaj Konvnte:

(a) termi “lëndë e rrezikshme” kupton një substancë apo përzierje substancash, të cilat në bazë të cilësive kimike, fizike apo toksike, veçmas apo të kombinuara, përbëjnë një rrezik;

(b) termi “kufiri i sasisë” për një lëndë të rrezikshme apo kategori të kësaj lënde kuptohet ajo sasi që e shpjeguar nga ligjet dhe rregullat kombëtare, duke pasur parasysh kushtet e veçanta, nëse tejkalohet, përbën një instalim me rrezik të madh;

(c) termi “instalim i madh i rrezikshëm” kuptohet ai që prodhon, përpunon, manipulon, përdor, livron apo magazinon, përkohësisht apo gjithnjë, një ose më shumë lëndë të rrezikshme, apo nënprodukte të këtyre lëndëve në sasi që e kalon kufirin e sasisë së lejuar;

(d) termi “aksident i madh” kuptohet një ndodhi e papritur si shpërthim, zjarr ose eksplozion gjatë veprimtarisë në një instalim të madh të rrezikshëm, duke përfshirë në të një ose më shumë lëndë të rrezikshme, e cila bëhet rrezik i madh për punëtorët, publikun apo ambientin, menjëherë apo edhe me veprim të vonuar;

(e) termi “raport i sigurimit” kupton një material me shkrim me karakter informativ teknik, menaxhimi apo operimi, duke trajtuar rreziqet dhe risqet e një instalimi të madh e të rrezikshëm dhe kontrollin e tyre dhe duke dhënë shpjegime për masat që duhen marrë për sigurimin e instalimit;

(f) termi “dështim i mundshëm” kupton çdo ngjarje të papritur, ku përfshihen një ose më shumë lëndë të rrezikshme, e cila, në sajë të sistemeve, veprimeve dhe efekteve jo frenuese, mund të çojë në një aksident të madh.

PJESA II:
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 4

1. Në bazë të ligjeve dhe rregullave kombëtare, kushteve dhe praktikave dhe në konsultim me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve e punëmarrësve dhe me palët e tjera të interesuara që mund të preken nga kjo, secili Anëtar duhet të formulojë, implementojë dhe të shqyrtojë periodikisht një politikë koherente kombëtare në lidhje me mbrojtjen e punëtorëve, publikut dhe ambientit kundër rreziqeve nga aksidentet e mëdha.

2. Kjo politikë do të zbatohet nëpërmjet masave parandaluese e mbrojtëse për instalimet e mëdha të rrezikshme, dhe, ku është e mundur, të zhvillojë e përdorë teknologjitë më të mira të sigurimit që janë në dispozicion.

Neni 5

1. Autoritetet kompetente ose një organ i miratuar i njohur nga organet kompetente, pas konsultimit me organizatat më të përfaqësuara të punëmarrësve e punëdhënësve dhe palët e tjera të interesuara që mund të preken nga kjo, do të ngrejnë një sistem për evidentimin e instalimeve me rreziqe të mëdha, siç përcaktohet në nenin 3 (c) në bazë të listës me lëndët e rrezikshme apo nënproduktet e këtyre lëndëve apo edhe të dyja, të shoqëruara me kufijtë e sasive për këto lëndë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e vendit apo standardet ndërkombëtare.

2. Sistemi i përmendur në paragrafin I më sipër duhet të shikohet dhe përmirësohet rregullisht.

Neni 6

Autoritetet kompetente, pas konsultimit me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve e punëmarrësve, do të marrin masa të veçanta për të mbrojtur transmetimin apo marrjen nga ata të informacioneve konfidenciale në përputhje me nenet 8, 12, 13 dhe 14, ruajtja e të cilëve lidhet me dëmin që mund t'i shkaktohet një punonjësi, biznesit deri në atë shkallë që nuk përbën ndonjë rrezik serioz për punëtorët, publikun apo ambientin.

PJESA III.
PËRGJEGJËSIA E PUNONJËSVE

EVIDENTIMI

Neni 7

Punonjësit duhet të evidentojnë e të kenë në kontroll, sipas sistemit cituar në nenin 5, çdo instalim me rrezikshmëri të lartë.

NJOFTIMI

Neni 8

1. Punonjësit duhet të njoftojnë autoritetet kompetente për çdo instalim me rrezikshmëri të lartë që kanë evidentuar:

(a) në një kohë të caktuar për çdo instalim ekzistues;

(b) në rastin kur bëhet fjalë për një instalim të ri, para fillimit të tij nga puna;

2. Punonjësit duhet, gjithashtu, të njoftojnë autoritetet kompetente para se ndonjë instalim me rrezikshmëri të lartë të mbyllet përgjithmonë.

MASAT NË NIVEL TË INSTALIMIT

Neni 9

Për çdo instalim me rrezikshmëri të lartë, punonjësit do të ndërtojnë e mbajnë një sistem për kontrollin e këtyre rreziqeve të mëdha ku përfshihen dispozitat për:

(a) evidentimin dhe analizat e rreziqeve dhe vlerësimin e tyre, duke përfshirë edhe reaksionin e mundshëm midis substancave;

(b) masat teknike, përfshi dizenjimin, sistemin e sigurimit, konstruksionin, përzgjedhjen e kimikateve, funksionimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin sistematik të instalimit;

(c) masat organizative, përfshi trajnimin dhe instruksionin për personelin, kushtet e pajisjeve me qëllim që të garantohet sigurimi i tyre, nivelin e stafit, orët e punës, përcaktimin e përgjegjësive dhe kontrollin për kontraktuesit e jashtëm dhe punonjësit e përhershëm në kantierin e instalimit;

(d) planet dhe procedurat emergjente, ku përfshihen:

(i) përgatitja e planeve dhe procedurave efektive për emergjencat, duke përfshirë procedurat për emergjencat kimike që do të merren në rastet e aksidenteve të mëdha, nga ato apo nëpërmjet tyre, duke testuar dhe vlerësuar periodikisht efektivitetin e kontrollin e tyre nëse është e nevojshme;

(ii) dispozitat për informimin mbi aksidentet e mundshme dhe planet e rasteve urgjente në zonë për autoritete dhe organet përgjegjëse për përgatitjen e planeve dhe procedurave të emergjencës për të mbrojtur publikun dhe ambientin jashtë zonës së instalimit;

(iii) nëse është e nevojshme, konsultimi me këto organe dhe autoritete;

(e) masat për të minimizuar pasojat e këtyre aksidenteve të rënda;

(f) konsultimin me punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre;

(g) përmirësimin e sistemit, përfshi masat për grumbullimin e informacionit dhe analizën e aksidenteve dhe dështimet e mundshme. Mësimet e nxjerrra duhet të diskutohen me punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre dhe do të mbahen shënim sipas ligjeve dhe praktikave të çdo vendi.

RAPORTI PËR SIGURIMIN

Neni 10

1. Punonjësit do të përgatisin një raport për sigurimin në bazë të kërkesave të nenit 9.

2. Raporti përgatitet në këto raste:

(a) kur ekzistojnë instalime me rrezikshmëri të lartë dhe brenda afateve, siç shprehet në ligjet dhe rregullat e çdo vendi;

(b) në rastet e instalimeve të reja me rrezikshmëri të lartë, para se të vihet në punë.

Neni 11

Punonjësit do të shqyrtojnë, plotësojnë dhe shtojnë raportin e sigurimit:

(a) në rastin e ndonjë modifikimi që ka influencë të rëndësishme në shkallën e sigurimit në instalimin e caktuar, apo në përpunimin dhe sasitë e substancave të rrezikshme që janë prezente;

(b) kur zhvillimet në njohuritë teknike ose në lidhje me vlerësimin e rreziqeve e bëjnë atë të nevojshme;

(c) në afatet siç përcaktohet në ligjet dhe rregullat e vendit;

(d) me kërkesë të autoriteteve kompetente.

Neni 12

Raportet për sigurimin që bëhet fjalë në nenin 10 dhe 11 punonjësit ua përcjellin apo dorëzojnë autoriteteve kompetente.

RAPORTIMI I AKSIDENTEVE

Neni 13

Punonjësit do të njoftojnë autoritetet kompetente dhe organet e tjera, të caktuara për këto qëllime menjëherë sapo ndodh aksidenti.

Neni 14

1. Brenda një afati të caktuar qysh më parë, pasi ndodh aksidenti, punonjësit i paraqesin autoriteteve kompetente një njoftim të detajuar ku përfshihet analiza e shkaqeve të aksidentit dhe pasojat e tij të menjëhershme në zonë dhe masat e marra për pakësimin e efektit të tij.

2. Raporti duhet të përmbajë rekomandime dhe masat e hollësishme që do të merren për parandalimin e përsëritjes së tij.

PJESA IV:
DETYRAT E AUTORITETEVE KOMPETENTE
PËRGATITJA E MASAVE TË EMERGJENCËS JASHTË ZONËS

Neni 15

Duke u nisur nga informacionet e marra nga punonjësit, autoriteti kompetent duhet të sigurojë që planet dhe procedurat e hartuara për rastet emergjente, të cilat përmbajnë masat për mbrojtjen e publikut dhe ambientit përreth çdo instalimi me rrezikshmëri të lartë, të jenë përpunuar në intervale kohore të caktuara dhe të jenë koordinuar me autoritetet e orgnet përkatëse.

Neni 16

Autoriteti kompetent do të sigurojë që:

(a) informimi mbi masat e sigurimit dhe sjellja korrekte që do të zbatohet në rastet e një aksidenti të madh u bëhen të njohura të gjithë njerëzve që kanë lidhje me efektet e aksidentit, pa u kërkuar nga këta të fundit, dhe ky informacion ripunohet e rishpërndahet në intervale të caktuara kohe;

(b) në rastin e një aksidenti të madh, jepet menjëherë alarmi;

(c) kur një aksident i madh mund të ketë efekte ndërkufitare, informacioni i caktuar në pikat (a) dhe (b) më lart u jepet edhe shteteve përkatëse, për të ndihmuar në koordinimin dhe kooperimin e masave që do të merren.

VENDOSJA E INSTALIMEVE ME RREZIKSHMËRI TË LARTË

Neni 17

Autoritetet kompetente duhet të ndërtojnë një politikë të qartë për përcaktimin e shesheve të ndërtimit për instalimet me rrezikshmëri të lartë që të jenë në distancën e duhur nga zonat e banimit e industriale, nga ambientet publike dhe masat e duhura për instalimet ekzistuese. Këto politika duhet të pasqyrojnë parimet e përgjithshme, të përcaktuara në Pjesën II të Konventës.

KONTROLLI

Neni 18

1. Autoritetet kompetente duhet të kenë një staf të trajnuar dhe të kualifikuar e me aftësitë e duhura, të japin ndihmën e mjaftueshme teknike dhe profesionale për të inspektuar, investiguar, vlerësuar dhe këshilluar për çështjet që bëhet fjalë në këtë Konventë dhe të sigurojnë përputhjen e tyre me ligjet dhe rregullat e çdo vendi.

2. Përfaqësuesit e punëdhënësit dhe ata të punëmarrësit të një instalimi me rrezikshmëri të lartë duhet t'u krijohet mundësia të shoqërojnë inspektorët që kontrollojnë zbatimin e masave të marra në mbështetje të kësaj Konvente, me kusht që inspektorët, në përputhje me rregullat e përgjithshme të

organeve kompetente, nuk e konsiderojnë këtë paragjykim për punën e tyre.

Neni 19

Autoritetet kompetente do të kenë të drejtë të shtyjnë çdo aktivitet që dyshohet se përbën kërcënim për aksidentet e rënda.

PJESA V:
TË DREJTAT DHE DETYRAT E PUNËTORËVE DHE PËRFAQËSUESVE TË TYRE

Neni 20

Punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre në një instalim me rrezikshmëri të lartë duhet të konsultohen nëpërmjet mekanizmave të përbashkët, me qëllim që të sigurojnë një sistem të sigurt në punë. Në mënyrë të veçantë, punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre duhet:

(a) të jenë të informuar mirë e për çdo gjë në lidhje me rreziqet e ndërmarrjes dhe pasojat e mundshme të tyre;

(b) të informohen për çdo urdhër, instruksion dhe rekomandim të bërë nga autoritetet kompetente;

(c) të konsultohen dhe të kenë mundësi të shfrytëzojnë dokumentet e mëposhtme:

(i) raportin e sigurimit;

(ii) planet dhe procedurat për emergjencën;

(iii) raportet mbi aksidentet;

(d) të instruktohen dhe trajnohen rregullisht për praktikat dhe procedurat për parandalimin e aksidenteve të rënda dhe të kontrollojnë kushtet të cilat mund të çojnë në aksidente dhe ndjekja e procedurave të emergjencës në rastet e ndodhjes të aksidentit të rëndë;

(e) në kuadër të punës së tyre dhe pa u vendosur në kushte disavantazhi, të marrin masa për kufizimin dhe nëse është e nevojshme për ndërprerjen e aktivitetit dhe ku, në bazë të eksperiencës e trajnimit të tyre, kanë justifikime të arsyeshme të besojnë se kemi të bëjmë me një rrezik eminent për një aksident të rëndë dhe të njoftojnë përgjegjësin apo të japë alarmin, sipas rastit, para dhe menjëherë se të ndërmarrë këto veprime;

(f) të diskutojë me punëdhënësin çdo rrezik të mundshëm që ata e konsiderojnë se mund të mundësojë e gjenerojë një aksident të rëndë dhe ka të drejtë të njoftojë autoritetet kompetente për këto rreziqe.

Neni 21

Punëtorët e punësuar në instalimin e aksidenteve të rënda:

(a) do të ndjekin të gjitha praktikat dhe procedurat në lidhje me parandalimin e aksidenteve të rënda dhe do të kontrollojnë gjendjen që dyshohet se mund të shkaktojnë aksidente të rënda brenda ndërmarrjes.

(b) nëse aksidenti ndodh, do të ndjekin të gjitha procedurat e emergjencës.

PJESA VI:
PËRGJEGJËSITË E SHTETEVE EKSPORTUESE

Neni 22

Kur në një Shtet Anëtar eksportues, përdorimi i lëndëve, teknologjive e proceseve të rrezikshme është e ndaluar si mundësi reale për aksidentet e rënda, informacioni për këto ndalime dhe arsyet e tij duhet t'i bëhen të njohura nga vendi anëtar eksportues për çdo vend tjetër importues.

PJESA VII:
DISPOZITA

Neni 23

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente do t'i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 24

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm për ato vende anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i të cilëve është regjistruar nga Drejtori i Përgjithshëm.

2. Hyn në fuqi 12 muaj pas datës kur është bërë regjistrimi i ratifikimit të dy Anëtarëve nga Drejtori i Përgjithshëm.

3. Më pas, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës kur është regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 25

1. Anëtari që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë pas kalimit të 10 vjetëve nga data kur Konventa hyri në fuqi për herë të parë, me anën e një akti drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Një denoncim i tillë nuk hyn në fuqi deri sa të kalojë një vit nga data e regjistrimit të tij.

2. Kur një Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë, brenda një viti pasi ka kaluar periudha dhjetëvjeçare e përmendur në paragrafin e mësipërm, nuk e shfrytëzon të drejtën për ta denoncuar atë siç shpjegohet në këtë nen, atëherë ajo do të jetë e vlefshme për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare, dhe më pas mund ta denoncojë këtë Konventë me mbarimin e çdo periudhe dhjetëvjeçare, sipas kushteve që siguron ky nen.

Neni 26

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i njoftojë të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për gjithë regjistrimet dhe denoncimet që i janë bërë të njohura atij nga Anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton Anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë komunikuar atij, Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i tërheqë vëmendjen e Anëtarëve të Organizatës për datën në të cilën Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 27

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me nenin 102 të Kartës të Kombeve të Bashkuara, të dhëna të plota për regjistirmin e të gjitha ratifikimeve dhe aktet e denoncimit të regjistruara nga ai në përputhje me dispozitat e nenit të mësipërm.

Neni 28

Në afate që mund t'i konsiderojë të nevojshme, Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës i paraqet Konferencës së Përgjithshme një raport për funksionimin e kësaj Konvente dhe shpreh dëshirën për të vendosur në axhendën e Konferencës çështjet për rishikimin e saj pjesërisht ose tërësisht.

Neni 29

1. Nëse Konferenca miraton një konventë të re, duke ripunuar këtë Konventë, pjesërisht apo

tërësisht, dhe nëse në Konventën e re nuk shprehet ndryshe:

(a) ratifikimi nga një Anëtar i Konventës se re të ripunuar do të përbëjë de juro denoncim të menjëhershëm të Konventës ekzistuese, pavarësisht dispozitave të nenit 25 më sipër, por me kusht që Konventa e re e ripunuar të ketë hyrë në fuqi.

(b) nga data kur Konventa e re e ripunuar hyn në fuqi, Konventa ekzistuese nuk hapet më për t'u ratifikuar nga Anëtarët.

2. Kjo Konventë, në çdo rast, mbetet në fuqi në formën e përmbajtjen e saj aktuale për ata Anëtarë që e kanë ratifikuar atë por nuk kanë ratifikuar Konventën e ripunuar.

Neni 30

Versioni i teksteve në anglisht dhe frëngjisht të kësaj Konvente kanë fuqi të barabartë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 24. 7. 2002
Doli nga shtypi më 25. 7. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë